



BASHKIA BERAT

RAPORTI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT Periudha Janar - Prill 2026

Maj 2026

PËRMBAJTJA

1.	VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM.....	3
1.1.	SITUATA E NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE.....	3
1.2.	Baza ligjore për hartimin e raportit të ekzekutimit të buxhetit.....	5
1.3.	Buxheti vjetor dhe Ndryshimet e buxhetit.....	5
1.4.	Çështje të barazisë gjinore.....	5
2.	INFORMACION FINANCIAR	6
2.1.	REALIZIMI I TË ARDHURAVE	8
2.2.	SHPENZIMET.....	23
2.2.1	Realizimi i planit të shpenzimeve të periudhës Janar - Prill 2026 sipas Njësive Shpenzuese	
2.2.2	Realizimi i planit të shpenzimeve të periudhës Janar - Prill 2026 sipas Natyrës Ekonomike	
Informacion i detajuar mbi realizimin e investimeve		27
Projektet e Investimeve me financim nga Buxheti i Bashkisë		27
Projektet e Investimeve me fonde nga transferata sektoriale për projektë të veçanta :.....		
Projektet e Investimeve me financim nga Buxheti i Shtetit		
2.2.3	Realizimi i planit të shpenzimeve të periudhës Janar - Prill 2026 sipas programeve buxhetore	31
2.2.3.1.	Analiza e detajuar e shpenzimeve sipas programeve buxhetore dhe treguesve të monitorimit të buxhetit	32
Programi: AA102 - Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse.....		32
Programi: AB102 - Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile		34
Programi: AC102 - Arsimi dhe Kujdesi Social.....		36
Programi: AD102 - Bujqësia, Administrimi i Pyjeve, Ujërrave, Shërbimi Veterinar & Siguria Ushqimore.....		39
Programi: AE102 - Siguria dhe Mbrojtja e Territorit		41
Programi: AF102 - Turizmi, Kultura dhe Sportet		43
Programi: AG102 - Rezerva & Kontigjenca		45
2.3	INFORMACION MBI DETYRIMET E PRAPAMBETURA DHE TË KRIJUARA.....	47
Raportet e Monitorimit të Njësive Shpenzuese.....		48
Tabelat e Raportit të Monitorimit të zbatimit të buxhetit Janar - Prill 2026.....		

1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

1.1.SITUATA E NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE

E shtrirë në Krahinën Malore të Shqipërisë Jugore dhe pjesërisht në Ulëtisrën Perëndimore në të dy anët e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të lumit Osum, Bashkia Berat është një atraksion jo vetëm turistik, por edhe një njësi ekonomike me resurse të mëdha zhvillimi.

Ajo përfshin brenda juridiksionit të saj administrativ qytetin e Beratit, njësitë: Otlak, Velabisht, Roshnik, dhe Sinjë. Në total nga 5 njësi administrative.

Tregues të rëndësishëm statistikorë bazë të saj janë:

Sipërfaqja: Bashkia Berat ka një sipërfaqe totale 380 km² e cila klasifikohet në tokë bujqësore prej 170 km², (përfshirë këtu tokat e kultivuara dhe jo të kultivuara) dhe tokë natyrore 180 km²(përfshirë këtu pyjet dhe kullotat)

Karakteristika të veçanta kanë njësitë përbërëse të bashkisë pjesë e ish komunave si :

Njësitë Otlak dhe Velabisht të cilat në sipërfaqen e tyre kanë më shumë tokë bujqësore, dhe njësitë Roshnik e Sinjë që kanë në strukturën e sipërfaqes së tyre teritoriale tokë bujqësore të fragmentarizuar me sipërfaqe më të madhe të tokës natyrore, dhe reliev kodrinor malor.

Bashkia Berat përshkohet nga lumi i Osumit dhe është tepër e pasur me ujëra nëntokësore e burime ujore sipërfaqësore .

Sipërfaqja totale ujore është 9 km². Sipërfaqet e banuara janë 4.63 km².

Industria dhe ekonomia shtrihen në një sipërfaqe prej 1.34 km².

Bashkia përshkohet nga 812 km rrugë

Qyteti i Beratit gjendet 58 m mbi nivelin e detit dhe ka një sip. 22.4 km² nga e cila 6.3 km² janë sipërfaqe urbane.

Ai pozicionohet:

- 125 km larg kryeqytetit të Shqipërisë dhe aeroportit “Nënë Tereza”
- 92 km nga porti i Durrësit
- 85 km nga porti i Vlorës
- 212 km nga porti i Sarandës
- 250 km nga pikat kufitare të Kakavijës dhe Kapshticës.

Ndarja administrative e Bashkisë Berat

Njësitë administrative përbërëse	Sipërfaqja (km ²)	Fshatrat/Qytetet në përbërje të NJA
Berat	19 km ²	Qyteti Berat
Otlak	52.7 km ²	Lapardha1, Lapardha 2, Qereshnik, Balibardhë, Dushnik, Moravë, Ullinjas, Vodëz e sipërme, Orizaj, Otlak
Velabisht	93.2 km ²	Malinat, Bilçë, Drobonik, Bardhaj i Ri, Starovë, Vetterrik, Rëmanicë, Gjoroven, Palikësht, Veleshnjë, Duhanas, Kodras, Velabisht
Sinjë	138.5 km ²	Kamçisht, Levan, Velçan, Osmenezet 1, Osmenezet 2, Plashnik i Vogël, Molisht, Sinjë
Roshnik	78.7 km ²	Bogdan i Poshtëm, Bogdan i Sipërm, Dardhë, Karkanjoz, Kostren i Madh, Kostren i Vogël, Mimias, Perisnak, Qafë Dardhë, Vojnik, Rabjak, Roshnik Qendër, Roshnik i Vogël

Berati është qendër ndërkombëtare e trashëgimisë kulturore (lagjet tradicionale të Mangalemit, Goricës dhe Kalasë, Muzeu Kombëtar i Ikonografisë “Onufri” dhe galeritë tjera, muze, kishat, xhamitë).

Bashkia Berat, me një histori mbi 2400-vjeçare, është ndër qytetet më të vjetra në vend. E shpallur “Qytet Muze” që në vitin 1961, ajo është sot pjesë e listës së UNESCO-s si Trashëgimi Kulturor Botëror. Territori i saj karakterizohet nga pasuri të rëndësishme natyrore, duke përfshirë një pjesë të Parkut Kombëtar të Tomorrit në lindje dhe malin e Shpiragut në perëndim.

Ekonomia e Bashkisë Berat mbështetet kryesisht në turizëm , bujqësi, agro-përpunim dhe sektorin e shërbimeve. Zonat rurale si Otlaku, Roshniku, Velabishti dhe Sinja kanë si bazë ekonomike bujqësinë, ku kultivimi i pemëve frutore, ullinjve dhe vreshtarisë zë një vend të rëndësishëm. Veçanërisht, prodhimi i ullirit përbën një nga produktet më të rëndësishme bujqësore, me një sipërfaqe të konsiderueshme të mbjellë me këtë kulturë.

Berati është zhvilluar si një qendër rajonale për agrobiznesin, tregtinë dhe turizmin, falë pozicionit të favorshëm gjeografik, trashëgimisë historike dhe aksesit në rrjetin rrugor kombëtar. Në strukturën e punësimit dominon sektori i shërbimeve, i ndjekur nga industria dhe më pas bujqësia, ndërsa në zonat rurale bujqësia mbetet burimi kryesor i të ardhurave dhe punësimit.

Struktura e biznesit në territor karakterizohet nga dominimi i bizneseve të vogla dhe të mesme, të cilat përbëjnë bazën e aktivitetit ekonomik lokal, të shoqëruara nga një prani më e kufizuar e bizneseve të mëdha. Aktiviteti ekonomik është i përqendruar kryesisht në qytetin e Beratit, ndërsa në njësitë administrative të tjera ai lidhet më shumë me prodhimin bujqësor dhe shërbimet përkatëse.

Në funksion të zhvillimit ekonomik dhe rritjes së të ardhurave vendore, bashkia është angazhuar në përmirësimin dhe organizimin e tregjeve, me fokus të veçantë në tregjet e produkteve bujqësore, duke synuar krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e qëndrueshëm të aktivitetit tregtar.

Nga ana demografike, bashkia paraqet një qëndrueshmëri relative, me një popullsi rreth 100 mijë banorë, çka përbën një bazë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe social të territorit.

Strategjia e zhvillimit afatgjatë/ strategjia territoriale . **Orientimi afatgjatë i bashkisë (drejtimet kryesore të saj. Burimi i informacionit: PPV/PZhS)**

Vizioni strategjik, që do të udhëheqë zhvillimin e Bashkisë së Beratit gjatë 15 viteve të ardhshme” *"Berati është një qytet i trashëgimisë kulturore botërore, me një strukturë të unifikuar e të konsoliduar, urbane dhe rurale, me cilësi të lartë jetese, i lidhur mirë me zonat qendrore të Shqipërisë përmes një infrastrukture moderne, si një destination i fuqishëm turistik dhe portë hyrëse/pritëse për një rajon të pasur natyror.*

Një nga asetet me me vlerë të Bashkisë Berat janë qytetarët e saj, ndaj rëndësi e veçantë i jepet nxitjes së kualifikimit të kapitalit njerëzor, për të rritur integritetin e të gjithë qytetarëve aktivenë tregun e punës.

Qëllimi kryesor: *harmonizimi i zhvillimit ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor me mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e pabarazive sociale dhe promovimin e zhvillimit intelektual të shoqërisë përmes parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit.*

Misioni i bashkisë në funksion të këtij vizioni zhvillimi është:

Vënia në dispozicion në mënyrë inteligjente e të gjitha burimeve financiare e njerëzore për harmonizimin e interesave publike dhe private, për zhvillim ekonomik e social në të gjithë territorin e Bashkisë Berat.

1.2. Baza ligjore për hartimin e raportit të ekzekutimit të buxhetit

Hartimi i raportit të ekzekutimit të buxhetit për periudhën janar-prill 2026 është realizuar në përputhje me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 64; ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjin nr. 68 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; nr. 97/2023 "Për Buxhetin e vitit 2024", Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 14.01.2026 të Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026"; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 101 datë 22.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028" i ndryshuar.

1.3. Buxheti vjetor dhe Ndryshimet e buxhetit

Për vitin 2026, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është 1,662,819,592 lekë, i miratuar me VKB nr. 101 datë 22.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028", konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Berat me shkresën nr. 977/1 datë 29.12.2025.

Në total të ardhurat janë planifikuar në shumën 1,662,819,592 lekë, po ashtu edhe shpenzimet e planifikuara janë 1,662,819,592 lekë.

Në periudhën janar – prill 2026 janë bërë shtesa në buxhetin e vitit 2026 në vlerën 189,369,619 lekë , si edhe ndryshime, miratuar me VKB si më poshtë :

- Me VKB nr. 20, datë 27.02.2026 " Për detajimin e fondeve të trashëguara nga viti 2025 në vitin 2026 për bashkinë Berat", konfirmuar nga Prefektura Berat me shkresë nr. 216/1 prot datë 07.03.2025, është marrë vendim nga këshilli bashkiak Berat për miratimin e shtesës së buxhetit me fondet e papërdorura dhe të trashëguara nga viti 2025, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 183,339,710.01 lekë lekë. Konkretisht është shtuar buxheti me fonde të trashëguara me burim :
 - të ardhurat vendore (kryesisht të ardhurat e muajit 12/25) shuma 134,207,016.87 lekë;
 - transferta e pakushtëzuar e përgjithshme 23,796,306.59 lekë;
 - transferta e pakushtëzuar sektoriale 21,728,793.13 lekë, nga e cila transferta specifike për mbrojtjen civile 2,142,319 lekë.
 - grante të huaja për projekte 2,789,040.00 lekë
 - të ardhura jashtë limitit sponsorizime 818,553.42 lekë
- Me VKB nr.22 date 27.02.2026 " Mbi përdorimin e grantit të bazuar në performancë për financimin e projektit "Mobilim i parkut tek biblioteka e qytetit" është shtuar në buxhet fondi prej 6,029,908.77 lekë për projektin "Mobilim i parkut tek biblioteka e qytetit". Fondi përfaqëson grantin e bazuar ne performance me burim të brendshëm 2,696,629.21 lekë dhe burim të huaj 3,333,279.56 lekë.

Buxheti i Bashkisë Berat, periudha janar – prill 2026 pas shtesave dhe ndryshimeve miratuar me VKB (kap.01+02+05+06) : 1,852,189,211 lekë.

1.4. Çështje të barazisë gjinore

Barazia mes grave dhe burrave përbën një të drejtë themelore për të gjithë. Autoritetet vendore përfaqësojnë nivelet më afër njerëzve, ndaj kemi përgjegjësi të drejtëpërdrejtë që me veprimet dhe politikat tona të nxisim procese që promovojnë një shoqëri të barabartë.

Ne, jemi të vetëdijshëm që përqafimi i konceptit të barazisë është një tregues i spikatur i një qeverisjeje të mirë. Ndaj, sot Bashkia Berat i kushton vëmendje të veçantë nxitjes për barazinë gjinore. Në këtë kuadër, Bashkia Berat ka ndërmarrë disa nisma për të nxitur përfshirjen demokratike dhe të barabartë të burrave dhe grave, djemve dhe vajzave në procese të ndryshme vendimmarrjeje dhe përfaqësuesimi si dhe ka ndjekur politika sociale për përkrahjen e tyre në mënyrë të barabartë. Aty ku ka qenë e mundur, Bashkia Berat ka përcaktuar edhe tregues performance me bazë gjinore, të cilat paraqiten në programet përkatëse buxhetore që shtjellohen në këtë dokument.

2. INFORMACION FINANCIAR

Situata financiare e Bashkisë Berat për vitin 2026 paraqitet e qëndrueshme, duke reflektuar një menaxhim të kujdesshëm të burimeve dhe një përdorim të balancuar të fondeve gjatë vitit buxhetor.

PASQYRË PËRMBLEDHËSE E REALIZIMIT TË BUXHETIT Janar – Prill 2026

Vlerat paraqiten në: ALL

Nr.	Kap.	Përshkrimi	Buxheti 2026 filleshtar	Buxheti 2026 pas shtesave e ndryshimeve	Struktura	Fakt	Realizimi i planit vjetor
			(miratuar ne m. 12/25)		%	janar-prill 2026	ne %
I		Totali i të ardhurave	1,662,819,592	1,852,189,211	100.00%	678,388,740	36.63%
1	01	Total Transfertate Pakushtezuara	1,012,830,674	1,061,052,403	57.29%	352,073,932	33.18%
a	01	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	611,514,899	611,514,899	33.02%	183,454,470	30.00%
b	01	Transf. e pakushtëzuar e përgjithshme trashëguar nga viti paraardhës		23,796,307	1.28%	23,796,307	100.00%
c	01	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	401,315,775	401,315,775	21.67%	120,397,733	30.00%
d	01	Transferta e pakushtëzuar sektoriale e trashëguar nga viti paraardhës	0	21,728,793	1.17%	21,728,793	100.00%
e	01	Granti bazuar ne Performance , Burim i brendshem	0	2,696,629	0.15%	2,696,629	100.00%
2	05	Total te ardhura te veta	646,483,000	780,690,017	42.15%	315,868,017	40.46%
a	05	Te ardhura te veta	646,483,000	646,483,000	34.90%	181,661,000	28.10%
b	05	Te ardhura te veta trashëguar nga viti paraardhës	0	134,207,017	7.25%	134,207,017	100.00%
3	02	Transferta nga grante te huaja	3,505,918	9,628,238	0.52%	9,628,238	100.00%
a	02	Grante te huaja per projekte	3,505,918	6,294,958	0.59%	6,294,958	100.00%
b	02	Granti bazuar ne Performance , Burim i huaj	-	3,333,280	0.18%	3,333,280	100.00%
4	06	Te ardhura jashte limitit (sponsorizimet)	-	818,553	0.04%	818,553	100.00%
II		Totali i Shpenzimeve	1,662,819,592	1,852,189,211	100.00%	478,268,573	25.82%
1		Totali shpenzime operative (korrente)	1,467,049,109	1,520,405,079	82.09%	443,200,947	29.15%
a		Shpenzime personeli	956,572,000	956,050,717	51.62%	290,236,543	30.36%
b		Shp.operative & mirembajtje & te tjera transferta	510,477,109	564,354,362	30.47%	152,964,404	27.10%
2		Shpenzime kapitale	195,770,483	331,784,132	17.91%	35,067,626	10.57%

Siç shihet nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme :

Buxheti i Bashkisë Berat për vitin 2026 është miratuar në vlerën **1,662,819,592 lekë** dhe, pas shtesave e ndryshimeve të miratuara gjatë periudhës raportuese, ka arritur në **1,852,189,211 lekë**.

Ecuria e të ardhurave

Të ardhurat totale të disponueshme për financimin e veprimtarisë së bashkisë janë realizuar në vlerën **678,388,740 lekë**, ose **36.63% e buxhetit të rishikuar**.

Burimin kryesor të financimit e përbëjnë transfertat nga buxheti i shtetit, të cilat zënë **57.29%** të totalit të burimeve financiare dhe janë realizuar në vlerën **352,073,932 lekë**, ose **33.18%** të planit të rishikuar.

Të ardhurat e veta dhe fondet e trashëguara nga viti paraardhës përbëjnë **42.15%** të totalit të burimeve financiare dhe janë realizuar në vlerën **315,868,017 lekë**, ose **40.46%** të planit të rishikuar. Brenda kësaj kategorie, të ardhurat e veta të arkëtuara gjatë periudhës Janar–Prill 2026 janë realizuar në vlerën **181,661,000 lekë**, ose **28.10%** të planit vjetor.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese janë reflektuar fondet e trashëguara nga viti paraardhës, grantet e performancës dhe grantet e huaja, të cilat janë përfshirë në buxhetin e rishikuar sipas destinacioneve përkatëse.

Ecuria e shpenzimeve

Shpenzimet totale janë realizuar në vlerën **478,268,573 lekë**, ose **25.82%** të planit të rishikuar vjetor.

Peshën kryesore të shpenzimeve e zënë shpenzimet operative (korrente), të cilat përfaqësojnë **82.09%** të buxhetit të rishikuar dhe janë realizuar në vlerën **443,200,947 lekë**, ose **29.15%** të planit.

Brenda tyre:

- Shpenzimet e personelit janë realizuar në vlerën **290,236,543 lekë**, ose **30.36%** të planit të rishikuar;
- Shpenzimet operative, të mirëmbajtjes dhe transfertat e tjera janë realizuar në vlerën **152,964,404 lekë**, ose **27.10%** të planit.

Shpenzimet kapitale përbëjnë **17.91%** të buxhetit të rishikuar dhe janë realizuar në vlerën **35,067,626 lekë**, ose **10.57%** të planit.

Analiza e treguesve financiarë tregon se gjatë katërmujorit të parë të vitit 2026 është siguruar financimi i plotë i funksioneve bazë të bashkisë dhe i shërbimeve publike nëpërmjet realizimit të shpenzimeve operative dhe të personelit.

Niveli i realizimit të investimeve paraqitet më i ulët krahasuar me shpenzimet korrente, për shkak të fazës së hershme të ciklit të investimeve, procedurave të prokurimit, kontraktimit dhe fillimit të zbatimit të projekteve. Një pjesë e konsiderueshme e fondeve të trashëguara, granteve dhe fondeve të dedikuara për investime pritet të materializohet në realizim financiar gjatë muajve në vijim.

Për rrjedhojë, ecuria e përgjithshme e zbatimit të buxhetit për periudhën Janar–Prill 2026 paraqitet në përputhje me dinamikën e zakonshme të ekzekutimit buxhetor dhe me fazën e realizimit të programeve dhe projekteve të planifikuara për vitin 2026.

2.1. REALIZIMI I TË ARDHURAVE

Buxheti i Bashkisë Berat për vitin 2026, pas ndryshimeve dhe shtesave të miratuara gjatë periudhës raportuese, është planifikuar në vlerën **1,852,189,211 lekë**.

Gjatë periudhës **janar – prill 2026**, janë realizuar të ardhura në shumën **678,388,740 lekë**, ose **36.63%** e planit vjetor.

Struktura e të ardhurave dominohet nga transfertat nga buxheti i shtetit, të cilat përbëjnë **57.29%** të burimeve totale financiare, ndërsa të ardhurat e veta zënë **42.15%** të totalit të burimeve të planifikuara.

Transfertat nga Buxheti i Shtetit

Nga transfertat e pakushtëzuara dhe transfertat sektoriale është realizuar shuma **352,073,932 lekë**, ose **33.18%** e planit vjetor. Realizimi është në përputhje me ritmin e disbursimit të fondeve nga buxheti i shtetit, ku si transfertat e pakushtëzuara e përgjithshme ashtu edhe transfertat sektoriale janë realizuar në masën **30%** të planit vjetor.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë përfshirë në buxhet fondet e trashëguara nga viti paraardhës në shumën **45,525,100 lekë**, si dhe fondi i përfutur nga **Granti i Performancës** në vlerën **2,696,629 lekë**, të cilat janë reflektuar plotësisht në buxhetin e vitit 2026.

Të Ardhurat e Veta

Të ardhurat e veta të bashkisë, përfshirë fondet e trashëguara nga viti paraardhës, janë realizuar në shumën **315,868,017 lekë**, ose **40.46%** e planit të rishikuar. Nga kjo shumë:

- **181,661,000 lekë** përfaqësojnë të ardhura të mbledhura gjatë periudhës janar-prill 2026;
- **134,207,017 lekë** përfaqësojnë fonde të trashëguara nga viti 2025.

Realizimi i të ardhurave të veta të vitit korent rezulton në nivelin **28.10%** të planit vjetor, duke reflektuar ecurinë e arkëtimeve të taksave, tarifave dhe burimeve të tjera vendore gjatë katërmujorit të parë të vitit.

Grante dhe Burime të Tjera

Gjatë periudhës raportuese janë përfshirë në buxhet edhe fonde nga **grantet e huaja** në shumën **9,628,238 lekë**, si dhe fonde **jashtë limitit (sponsorizime)** në vlerën **818,553 lekë**, të cilat janë reflektuar në masën 100% në buxhetin e rishikuar.

Të ardhurat sipas burimit të financimit

Vlerat paraqiten në: ALL

Nr.	Kap.	Përshkrimi	Buxheti 2026 fillestar	Buxheti 2026 pas shtesave e ndryshimeve	Struktura	Fakt	Realizimi i planit vjetor
			(miratuar ne m. 12/25)		%	janar-prill 2026	ne %
I		Totali i të ardhurave	1,662,819,592	1,852,189,211	100.00%	678,388,740	36.63%
1	01	Total Transfertate Pakushtezuara	1,012,830,674	1,061,052,403	57.29%	352,073,932	33.18%

a	01	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	611,514,899	611,514,899	33.02%	183,454,470	30.00%
b	01	Transf. e pakushtëzuar e përgjithshme trashëguar nga viti paraardhës	0	23,796,307	1.28%	23,796,307	100.00%
c	01	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	401,315,775	401,315,775	21.67%	120,397,733	30.00%
d	01	Transferta e pakushtëzuar sektoriale e trashëguar nga viti paraardhës	0	21,728,793	1.17%	21,728,793	100.00%
e	01	Granti bazuar ne Performance , Burim i brendshëm	0	2,696,629	0.15%	2,696,629	100.00%
2	05	Total te ardhura te veta	646,483,000	780,690,017	42.15%	315,868,017	40.46%
a	05	Te ardhura te veta	646,483,000	646,483,000	34.90%	181,661,000	28.10%
b	05	Te ardhura te veta trasheguar nga viti paraardhes	0	134,207,017	7.25%	134,207,017	100.00%
3	02	Transferta nga grante te huaja	3,505,918	9,628,238	0.52%	9,628,238	100.00%
a	02	Grante te huaja per projekte	3,505,918	6,294,958	0.59%	6,294,958	100.00%
b	02	Granti bazuar ne Performance , Burim i huaj	-	3,333,280	0.18%	3,333,280	100.00%
4	06	Te ardhura jashte limitit (sponsorizimet)	-	818,553	0.04%	818,553	100.00%

2.1.1 TË ARDHURAT VENDORE

Për periudhën janar–prill 2026, të ardhurat nga burimet e veta dhe taksat e ndara janë realizuar në shumën **181,661,000 lekë**, ose **28.1%** e planit vjetor prej **646,483,000 lekë**.

Krahasuar me vitin 2025, kur të ardhurat e realizuara ishin **520,822,184 lekë** në nivel vjetor, ecuria e arkëtimeve gjatë katërmujorit të parë paraqitet në përputhje me ciklin normal të mbledhjes së të ardhurave vendore, duke pasur parasysh se një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve paguhen në këstet e mëvonshme të vitit.

Në tërësi, realizimi prej **28.1%** i planit vjetor të të ardhurave vendore dhe taksave të ndara konsiderohet i pranueshëm për periudhën janar–prill. Ecuri pozitive paraqesin taksa e ndikimit në infrastrukturë, tarifat vendore, taksa e tabelës dhe taksa mbi truallin. Nga ana tjetër, taksa mbi tokën bujqësore, të ardhurat nga asetet dhe disa kategori të të ardhurave administrative kërkojnë monitorim më të afërt gjatë pjesës së mbetur të vitit për të garantuar realizimin e objektivave buxhetore.

Taksa e Pasurisë së Paluajtshme

Nga taksa e pasurisë së paluajtshme janë arkëtuar **22,618,000 lekë**, ose **29%** e planit vjetor.

Brenda këtij grupi:

- Taksa mbi ndërtesën paraqet performancë të mirë me **34%** realizim të planit;
- Taksa mbi truallin është realizuar në masën **42%**, duke reflektuar një ecuri pozitive të arkëtimeve;
- Taksa mbi tokën bujqësore paraqitet me nivel më të ulët realizimi **9%**, duke mbetur një nga zërat që kërkon vëmendje të shtuar gjatë muajve në vijim.

Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja

Ky zë vijon të mbetet një nga burimet më të rëndësishme të të ardhurave vendore. Gjatë katërmujorit të parë janë arkëtuar **29,763,000 lekë**, ose **35%** e planit vjetor.

Performanca pozitive lidhet me vijimësinë e aktivitetit ndërtimor në territorin e bashkisë dhe me procesin e pajisjes me leje ndërtimi.

Taksat e Tjera Vendore

Nga taksat e tjera vendore janë realizuar **2,597,000 lekë**, ose **28%** e planit.

Brenda këtij grupi kemi:

- Realizim shumë i mirë i **taksës së tabelës**, në masën **61%** të planit;
- Realizim më i ulët i **taksës hoteliere**, në nivelin **19%**, e cila pritet të përmirësohet gjatë sezonit turistik.

Tarifat Vendore

Tarifat vendore përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave të bashkisë dhe gjatë periudhës raportuese janë realizuar në shumën **92,192,000 lekë**, ose **34%** të planit vjetor.

Ndër zërat kryesorë kemi:

- Tarifa e menaxhimit të mbetjeve: **35,897,000 lekë** (33%);
- Tarifa e ndriçimit publik: **14,390,000 lekë** (30%);
- Tarifa e gjelbërimit: **11,496,000 lekë** (28%);
- Tarifa për zënien e hapësirës publike: **5,364,000 lekë** (34%);
- Tarifa e parkimit: **43%** realizim, mbi ritmin mesatar të planit.
- Tarifa e institucioneve të arsimit, e realizuar në nivelin **21%** të planit vjetor.

Të Ardhurat nga Asetet dhe Aktiviteti Ekonomik

Ky grup është realizuar në shumën **4,081,000 lekë**, ose **4%** të planit vjetor.

Pothuajse të gjitha të ardhurat burojnë nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë. Niveli i ulët i realizimit në këtë fazë të vitit lidhet me karakteristikat e kontratave dhe afatet e pagesave, por mbetet një zë që duhet monitoruar për të garantuar realizimin e planit vjetor.

Të Ardhurat Administrative

Nga kamatëvonesat dhe të ardhurat administrative janë arkëtuar **10,066,000 lekë**, ose **21%** e planit vjetor.

Taksat e Ndara

Të ardhurat nga taksat e ndara janë realizuar në shumën **20,344,000 lekë**, ose **32%** e planit.

Performanca më e mirë paraqitet në:

- Taksën vjetore të mjeteve të përdorura, me **39%** realizim;
- Të ardhurat e tjera të ndara, me **34%** realizim.

Ndërkohë, realizimi i të ardhurave nga renta minerare dhe tatimi mbi të ardhurat personale paraqitet më i ulët gjatë periudhës raportuese, për shkak të mënyrës së shpërndarjes dhe transferimit të këtyre fondeve.

Të ardhurat vendore të planifikuara për vitin 2026, si dhe realizimi i tyre për periudhën janar-prill

Vlerat paraqiten në: ALL

	Burimet Buxhetore	2024	2025	2026 (Janar - Prill)			Realizimi ne %
		Fakti	Fakti	Plani Fillestar	Plani i Rishikuar	Fakti Kumulativ	
1	TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA	395,305,992	433,671,101	582,809,000	582,809,000	161,317,000	28%
1.1	TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME	56,157,368	59,906,822	77,980,000	77,980,000	22,618,000	29%
1.1.1	Taksa mbi Ndërtësën	42,907,916	47,209,513	51,460,000	51,460,000	17,508,000	34%
1.1.2	Taksa mbi tokën bujqësore	6,752,042	6,148,132	18,433,000	18,433,000	1,717,000	9%
1.1.3	Taksa mbi truallin	6,497,410	6,549,177	8,087,000	8,087,000	3,393,000	42%
1.1.4	Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	0	0	0	0	0	0
1.2	TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA	55,101,213	72,399,193	84,342,000	84,342,000	29,763,000	35%
1.2.1	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	55,101,213	72,399,193	84,342,000	84,342,000	29,763,000	35%
1.3	TAKSA TË TJERA VENDORE	8,641,839	8,361,971	9,202,000	9,202,000	2,597,000	28%
1.3.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	0	0	0	0	0	0
1.3.2	Taksa vendore në shërbimin hotelier	6,727,547	6,533,459	7,216,000	7,216,000	1,387,000	19%
1.3.3	Taksa e tabelës	1,914,292	1,828,512	1,986,000	1,986,000	1,210,000	61%
1.3.4	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testamen...	0	0	0	0	0	0
1.3.5	Taksa e përkohëshme	0	0	0	0	0	0
1.4	TARIFA VENDORE	204,378,976	224,910,710	270,439,000	270,439,000	92,192,000	34%
1.4.1	Tarifa e menaxhimit të mbetjeve	80,643,115	85,257,980	107,434,000	107,434,000	35,897,000	33%
1.4.2	Tarifa për zënien e hapësirës publike	13,895,337	15,698,569	15,775,000	15,775,000	5,364,000	34%
1.4.3	Tarifa për ndriçimin publik	34,555,832	37,445,390	48,606,000	48,606,000	14,390,000	30%
1.4.4	Tarifa për gjelbërimin	29,423,792	32,400,997	41,799,000	41,799,000	11,496,000	28%
1.4.5	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	0	0	0	0	0	0
1.4.6	Tarifa të institucioneve të arsimit	15,359,640	16,314,894	23,350,000	23,350,000	4,888,000	21%
1.4.7	Tarifa të institucioneve të kulturës dhe sportit	0	0	0	0	0	0
1.4.8	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	0	0	0	0	0	0
1.4.9	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	1,781,516	1,501,887	1,535,000	1,535,000	446,000	29%
1.4.10	Tarifa e përkohëshme	8,010,192	8,607,837	11,724,000	11,724,000	3,202,000	27%
1.4.11	Tarifa e parkimit	2,579,303	7,302,588	6,394,000	6,394,000	2,735,000	43%
1.4.12	Tarifa të tjera	18,130,249	20,380,568	13,822,000	13,822,000	13,774,000	100%
1.5	TË ARDHURA NGA ASETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK	21,949,565	36,278,878	92,499,000	92,499,000	4,081,000	4%
1.5.1	Të ardhura nga ndërmarrjet publike	0	0	0	0	0	0
1.5.2	Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të bashkisë	21,949,565	36,278,878	92,499,000	92,499,000	4,081,000	4%
1.5.3	Të ardhura nga partneriteti publik privat	0	0	0	0	0	0
1.5.4	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	0	0	0	0	0	0

1.5.5	Shitja e asetëve financiare	0	0	0	0	0	0
1.5.6	Shitja e asetëve fikse të prekshme / paprekshme	0	0	0	0	0	0
1.5.7	Të tjera	0	0	0	0	0	0
1.6	TË TJERA ADMINISTRATIVE	49,077,031	31,813,527	48,347,000	48,347,000	10,066,000	21%
1.6.1	Kamatëvonesat	36,982,911	31,813,527	48,347,000	48,347,000	10,066,000	21%
1.6.2	Gjoha, sekuestre dhe zhvdëmtime	0	0	0	0	0	0
1.6.3	Të tjera	12,094,120	0	0	0	0	0
2	TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	70,820,389	87,151,083	63,674,000	63,674,000	20,344,000	32%
2.1	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	40,173,890	45,216,362	42,183,000	42,183,000	16,515,000	39%
2.2	Renta minerare	8,193	7,368	180,000	180,000	2,000	1%
2.3	Tatimi mbi të ardhurat personale	28,112,048	39,222,179	18,000,000	18,000,000	2,701,000	15%
2.4	Të tjera	2,526,258	2,705,174	3,311,000	3,311,000	1,126,000	34%
	Total 1+2	466,126,381	520,822,184	646,483,000	646,483,000	181,661,000	28.1%

Ndërkohë që për periudhën janar–prill 2026, realizimi i të ardhurave vendore në nivel bashkie paraqitet në masën **28.1% ndaj planit vjetor**, kundrejt planit të parashikuar për katërmujorin niveli i realizimit rezulton rreth **81%**. Në nivel të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave, realizimi është në masën **30% ndaj planit vjetor** dhe rreth **83% ndaj planit të periudhës**.

1. Taksat dhe tarifat nga biznesi

Gjatë katërmujorit të parë të vitit 2026, të ardhurat nga taksat dhe tarifat e biznesit paraqiten me ecuri të qëndrueshme. Niveli i realizimit kundrejt planit të periudhës është **99%**, në vlerën **78,355,000 lekë**, duke reflektuar arkëtimin e kështit të parë të detyrimeve të vitit.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, kjo kategori paraqet rritje në vlerën **1,971,000 lekë**, duke treguar vazhdimësi pozitive në nivelin e arkëtimeve dhe në bazën tatimore të biznesit.

Lidhur me dinamikën e subjekteve ekonomike, gjatë periudhës janar–prill 2026 rezulton se:

- janë regjistruar **93 subjekte të reja**;
- kanë aplikuar për çregjistrim **30 subjekte**;
- kanë pezulluar aktivitetin **61 subjekte**;
- janë riaktivizuar **3 subjekte**.

Këto të dhëna tregojnë një lëvizje normale të aktivitetit ekonomik, me hyrje të reja në regjistrin e tatimpaguesve dhe vijimësi të aktivitetit tregtar në territorin e bashkisë.

2. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat familjare

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat e familjeve për periudhën janar–prill 2026 janë realizuar në vlerën **29,698,000 lekë**.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, kjo kategori paraqet realizim më të ulët në vlerën **5,533,000 lekë**, duke reflektuar ritëm më të ngadaltë arkëtimi gjatë muajve të parë të vitit.

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në këtë ecuri lidhen me:

- ritmin e mbledhjes dhe ndjekjes së detyrimeve në terren;
- nivelin e aftësisë paguese të familjeve;
- ndikimin e rritjes së çmimeve në përballimin e detyrimeve vendore nga ana e qytetarëve.

3. Monitorimi dhe administrimi i të ardhurave

Gjatë periudhës raportuese, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave ka vijuar monitorimin e përditshëm të ecurisë së të ardhurave në nivel bashkie, duke ndjekur raportin plan-fakt për secilin zë të të ardhurave.

Njëkohësisht është punuar për përditësimin dhe administrimin e databazës së debitorëve, si dhe për ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura dhe detyrimeve të vitit korent.

Në tërësi, realizimi i të ardhurave vendore gjatë periudhës janar-prill 2026 paraqitet i qëndrueshëm, me performancë pozitive në të ardhurat nga biznesi dhe me ritëm më të moderuar në arkëtimin e taksave dhe tarifave familjare.

Pavarësisht diferencës së krijuar ndaj planit të katërmujorit të parë, masat e marra për monitorimin e përditshëm të arkëtimeve, ndjekjen e debive dhe administrimin fiskal krijojnë bazë për përmirësimin e ritmit të realizimit gjatë muajve në vijim dhe për afrimin me objektivat e planifikuara vjetore.

2.1.2 TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR

Transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga burimet e veta, janë burimi kryesor i buxhetit të bashkisë. Bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Për vitin 2026, Bashkisë Berat i është akorduar fillimisht transferta e pakushtëzuar e përgjithshme 611,514,899 lekë, nga të cilat 90,994,728 lekë për rritjen e pagave. Deri në mbyllje të periudhës raportuese nuk ka ndryshime të transfertës.

Vlerat paraqiten në: ALL

Burimet Buxhetore	2024	2025	2026 (Janar - Prill)		
	Fakti	Fakti	Plani Fillestar	Plani i Rishikuar	Fakti Kumulativ
TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME	478,037,576	574,488,606	611,514,899	611,514,899	183,454,470
Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	446,779,023	476,758,507	520,520,171	520,520,171	153,122,894
Rritja e nivelit të pagave	31,258,553	68,465,241	90,994,728	90,994,728	30,331,576
Fond shtesë nga Kuvendi	0	29,264,858	0	0	0

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme e trashëguar nga viti 2025 është 23,796,306.59 lekë.

Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Transferta e pakushtëzuar sektoriale përdoret për të financuar funksionet e transferuara si më poshtë:

Personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar.

Në transfertën e pakushtëzuar sektoriale të vitit 2026, janë akorduar fondet për personelin edukativ dhe ndihmës të arsimit parashkollor si dhe fondet për personelin ndihmës të arsimit parauniversitar.

Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH)

Në transfertën e pakushtëzuar të vitit 2026, janë fondet për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit. Në këto fonde bëjnë pjesë fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Rrugët rurale

Në transfertën e pakushtëzuar sektoriale të vitit 2026, janë alokuar fondet për rrugët rurale të transferuara nga qarku në bashki.

Administrimi i pyjeve dhe kullotave

Në transfertën e pakushtëzuar sektoriale të vitit 2026, janë planifikuar fondet për Shërbimin Pyjor dhe kullosor. Në këtë fond përfshiheshin fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Ujitja dhe Kullimi

Në transfertën e pakushtëzuar sektoriale të vitit 2026, janë planifikuar fondet për ujitjen dhe kullimin. Në këtë fond përfshiheshin fondet për pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve si dhe shpenzimet operative.

Arsimi i mesëm i përgjithshëm

Në transfertën e pakushtëzuar sektoriale të vitit 2026, janë akorduar fonde për arsimin e mesëm të përgjithshëm. Në këtë transfertë janë të përfshira: fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit (punonjës dhe edukator) dhe shpenzimet operative.

Qendrat e Shërbimeve Sociale

Në transfertën e pakushtëzuar sektoriale të vitit 2026 janë akorduar fondet për paga dhe sigurime shoqërore të personelit dhe shpenzime operative të Qendrës Rezidenciale “Lira”

Për vitin 2026, Bashkisë Berat i është akorduar fillimisht transferta e pakushtëzuar sektoriale 401,315,775 lekë. Deri në mbyllje të periudhës raportuese nuk ka ndryshime të transfertës.

Niveli i transfertës së pakushtëzuar sektoriale e akorduar për vitin 2026

Vlerat paraqiten në: ALL

Burimet Buxhetore	2024	2025	2026 (Janar - Prill)		
	Fakti	Fakti	Plani Fillestar	Plani i Rishikuar	Fakti Kumulativ
TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE	309,134,038	368,301,683	401,315,775	401,315,775	120,397,733
Konviktet e arsimit parauniversitar	31,648,000	30,230,514	31,137,429	31,137,429	9,341,229
Arsimi parashkollor - Për Personelin Arsimor	122,272,413	160,068,999	172,156,073	172,156,073	49,469,665
Arsimi parashkollor - Për stafin mbështetës	49,011,000	50,968,345	65,314,720	65,314,720	21,771,573
Arsimi parauniversitar	14,507,470	17,476,556	21,215,770	21,215,770	6,364,731
Mbrojtja nga zjarri	36,739,691	50,014,711	50,978,373	50,978,373	15,293,512
Mbrojtja sociale	25,444,514	26,207,850	26,994,085	26,994,085	8,098,226
Administrimi i pyjeve	6,730,984	6,999,775	8,336,963	8,336,963	2,504,089
Rrugët	5,987,236	6,174,982	6,362,134	6,362,134	1,908,640
Ujitja dhe Kullimi	16,792,730	17,463,322	18,820,228	18,820,228	5,646,068
Të tjera (Granti Bazuar në Performancë, burimi i brendshëm)	0	2,696,629	0	0	0

Transferta e pakushtëzuar sektoriale e trashëguar nga viti 2025 është 21,728,793.13 lekë.

2.1.3 TRANSFERTA NGA GRANTE TË HUAJA

Planifikimi i transfertave nga grante të huaja për periudhën janar–prill 2026 arrin në 6,122,320 lekë, të shpërndara në tre programe kryesore të bashkisë, duke mbështetur projekte në fushën e infrastrukturës, zhvillimit rural dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Këto fonde përfaqësojnë komponentin e bashkëfinancimeve dhe projekteve me partnerë të huaj dhe ndikojnë në rritjen e kapaciteteve zhvillimore të bashkisë në sektorë prioritarë.

Vlerat paraqiten në: ALL

Kod Instituti	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Plan 2026
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				6,122,320
2102001		AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile			3,333,280
2102001	02	AD102	P626AIC	231	Mobilim i parkut pranë bibliotekës së qytetit (Granti I Performances burim I huaj)	3,333,280
2102001		AD102	Bujqësia, Administrimi i Pyjeve, Ujërave, Shërbimi Veterinar & Siguria Ushqimore			2,138,259
2102001	02	AD102	P422AAF	602	Shpenzime për menaxhimin e projektit "HEVON"	2,138,259
2102001		AF102	Turizmi, Kultura dhe Sportet			650,781
2102001	02	AF102	P823AAD	602	Shpenzime operative për projektin "RiseUp ËB"	650,781

2.1.4 TË ARDHURA NGA SPONSORIZIMET

Bashkia Berat ka patur në dispozicion të ardhura nga Sponsorizimet (të ardhura jashtë limitit) për t'i përdorur specifikt për objekte sipas marrëveshjeve/kontratave me sponsorizuesit. Nga viti 2025 u trashëguan 818,553.42 lekë nga sponsorizimet. Gjatë periudhës raportuese nuk kemi pasur fonde shtesë nga me burim sponsorizimet .

Vlerat paraqiten në: ALL

Kod Instituti	Kap. Fin.	Programi	Llog.	Pershkrimi	Plan 2026
Të ardhurat nga Sponsorizimet					818,553.42
2102001	06	AA102	602	Erasmus +	503.42
2102001	06	AB102	231	Alpha Bank, sponsorizim për rikonstruksionin e Shatervanit	205,000
2102001	06	AB102	231	Sponsorizim FLAG Projekti "Siguria publike në nivel vendor"	562,000
2102001	06	AC102	602	Te ndryshem por te barabarte & Askush te mos mbetet si ju	407
2102001	06	AC102	231	Save the Children, "Kend sportiv dhe rekreativ në shkollën Velabisht, Berat"	32,870
2102001	06	AD102	602	"Trans Adriatik Pipeline"	17,773

2.1.5 TRANSFERTA E KUSHTËZUAR

Transferta e kushtëzuar përbëhet nga fondet e deleguara për mbulimin e shërbimit të Gjendjes Civile, fondet për mbështetje me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë dhe për personat me aftësi ndryshe, si edhe transferta për projekte të veçanta. Transferta e kushtëzuar e akorduar në periudhën raportuese është 236,375,201 leke.

Transferta të Kushtëzuar për funksione të deleguara

Transferta e kushtëzuar në buxhetin e vitit 2026, jepet për financimin e shpenzimeve për funksionet e deleguara, shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për kryerjen e shërbimit të Gjendjes Civile. Këto fonde përdoren nga njësitë e qeverisjes vendore vetëm për qëllimin për të cilin janë dhënë.

Në periudhën raportuese Bashkisë Berat i është akorduar Transferta të Kushtëzuar për funksione të deleguara në shumën 10,538,700 lekë e detajuar si më poshtë :

Vlerat paraqiten në: ALL

Gr.	Programi	Kapitulli	Produkti	Artikulli	Emertimi	Plan 2026
1. Transferta e Kushtëzuar për Funksione të Deleguara						10,538,700
16	01170	01	91603AA	600	Paga Gjendja Civile	9,000,000
16	01170	01	91603AA	601	Sigurime Gjendja Civile	1,472,200
16	01170	01	91603AA	606	Fond shperblimi per dalje ne pension punonjes gj. civile	66,500

Fonde për Ndhmën Ekonomike për Pagesën e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe për Përkujdesjen Shoqërore.

Fondet e kushtëzuara për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar dhe përkujdesjen shoqërore, janë fonde të Ministrisë së linjës. Ato iu delegohen njësitë të qeverisjes vendore të cilat bëjnë vlerësimin e nevojave si dhe kryejnë pagesat e ndihmën ekonomike, të personave me aftësi të kufizuar dhe për përkujdesjen shoqërore.

Në periudhën raportuese Bashkisë Berat i është akorduar Transferta të Kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike për Pagesën e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe për Përkujdesjen Shoqërore në shumën 135,369,000 lekë detajuar si më poshtë :

Vlerat paraqiten në: ALL

Gr.	Programi	Kapitulli	Produkti	Artikulli	Emertimi	Plan 2026
2. 'Fonde për Ndhmën Ekonomike për Pagesën e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe për Përkujdesjen Shoqërore						135,369,000
13	10430	01	91207AA	606	Ndihma ekonomike	10,000,000
13	10430	01	91307AB	606	PAK	124,205,000
13	10430	01	91307AH	606	Transferat per Personelin e qendres "Streheza"	1,164,000

Transferta për projekte të veçanta

Në periudhën raportuese Bashkisë Berat i janë akorduar fonde për projekte të veçanta në shumën 90,467,501 lekë detajuar si më poshtë :

Vlerat paraqiten në: ALL

Gr.	Programi	Kapitulli	Produkti	Artikulli	Emertimi	Plan 2026
3. Transferta për projekte të veçanta						90,467,501
3.1 Fonde per Arsimin Parashkollor dhe te Mesem						71,514,901
11	09230	01	18BD066	231	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "22 Tetori"	27,175,252
11	09230	01	18BD085	231	Rikonstruksion total i Shkolles se Mesme te Bashkuar "Koco Brisku" Lapardha	25,084,269
11	09120	01	91103AC	602	Bursa per nxenesit e arsimit parauniversitar	3,952,800
11	09230	01	91104AA	602	Bursa per nxenesit e arsimit parauniversitar	1,326,000
04	09240	01	90403AH	606	Bursa te perfituara nga nxenesit e AP	13,976,580
3.2 Mbrojtja civile dhe emergjencat						18,952,600
17	10910	01	91707AB	604	Shpenzime per marrjen e masave parandaluese mbrojtese rehabilituese ne objekte te ndryshme	9,476,300
17	10910	01	21AD502	231	Shpenzime kapitale per marrjen e masave parandaluese mbrojtese rehabilituese ne objekte te ndryshme	9,476,300

Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore

1. Fondi për **Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** është një mekanizëm financiar që mbështet politikën kombëtare të parandalimit dhe menaxhimit rajonal dhe vendor të fatkeqësive natyrore e të tjera.

2.Për vitin 2025, Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore është pjesë e fondit të akorduar në buxhetin e vitit 2025 në programin “Emergjencat Civile”, në Ministrinë e Mbrojtjes.

3.Vlerësimi i projekteve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore aplikuese bëhet me vendim të Komisionit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, i cili kryesohet nga Drejtori i AKMC - Kryetar dhe ka në përbërje anëtarë nga struktura përgjegjëse për mbrojtjen civile (Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile), anëtarë nga Ministria e Mbrojtjes, anëtar nga Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe anëtarë nga Shoqata për Autonomi Vendore.

4.Komisioni për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore miraton; specifikimet, rregullat dhe kriteret **për financimin e projekteve në infrastrukturë dhe për blerje pajisjesh për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore** si dhe vlerësimin e projekteve.

5.Sekretariati teknik për Fondin e Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore ngrihet pranë AKMC dhe ndihmon punën e Komisionit për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore.

6.Fondi i Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore me përparësi duhet të financojë projektet e investimeve tashmë në proces. Pjesa e financimit të projekteve në proces vendoset në listën e investimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, në përputhje me ecurinë e projektit. Ministria e Mbrojtjes mund të kërkojë rialokime midis projekteve të Fondit të Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore, sipas procedurave të miratuara për investimet publike.

7.Thirrjet për aplikim në Fondin Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore për vitin buxhetor 2026, mund të bëhen që në nëntor të vitit paraardhës deri në 31 Janar të vitit korent.

8.Projektet e përzgjedhura nga Komisioni për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dërgohen për miratim pranë Këshillit të Ministrave brenda datës 15 Shkurt të vitit korent.

9. Këshilli i Ministrave miraton projektet e reja fituese, si dhe autoritetin kontraktor për zbatimin e projekteve të reja sipas njësive të vetëqeverisjes vendore brenda datës 28 Shkurt të vitit korrent.

10. Fondi i Parandalimit dhe Menaxhimit të Fatkeqësive Natyrore nuk trashëgohet në vitin e ardhshëm, buxhetor.

11. Subjektet aplikuese dhe zbatuese janë njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Në kuadër të kërrij fondi Bashkia Berat ka aplikuar për financimin e projektit “ Mbrojtja nga gërryerja e lumit Osum, rruga ByPass pranë urës së Bilçës, me vlerë 35,981,765.63 lekë.

Projekti është shpallur fitues në muajin maj.

2.2. SHPENZIMET

Buxheti i Bashkisë Berat i vitit 2026, fillestar, u miratua në shumën 1,662,819,592 lekë. Krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2025 është planifikuar me rritje 117,550,790 lekë, ose në masën 7.6 %.

Pas shtesave të buxhetit me fondet e trashëguara nga viti 2025, me transfertat të tjera gjatë vitit, buxheti i vitit 2026 i rishikuar 1,852,189,211 lekë.

Realizimi i buxhetit në nivelin 478,268,568 lekë ose 25.8% ndaj planit vjetor të rishikuar, duke reflektuar një administrim të qëndrueshëm të fondeve dhe vijimësi në ofrimin e shërbimeve.

2.2.1 Realizimi i planit të shpenzimeve të periudhës Janar – Prill 2026 sipas Njësive Shpenzuese

Buxheti i bashkisë Berat është planifikuar dhe realizuar në 6 njësi shpenzuese sipas programeve buxhetore që ato menaxhojnë. Përshtatja e gjithë informacionit financiar është mbi bazën e strukturës së 9 fushave/funksioneve kryesore që janë përgjegjësi ligjore e njësive të qeverisjes vendore sipas ligjit 139/2015, sipas kodifikimit COFOG, i cili unifikon njëkohësisht dhe marrëdhënien me Qeverinë Qendrore /Degën e Thesarit.

Bashkia Berat siguron ofrimin e shërbimeve publike, sociale, komunitare, etj, nëpërmjet 6 Njësive Shpenzuese, të cilat menaxhojnë buxhetin në programet përkatëse :

1. Bashkia Berat menaxhon 48.8 % të totalit të buxhetit të bashkisë v.2026
2. Agjencia e Shërbimeve Publike menaxhon 15.9 % të totalit të buxhetit të bashkisë v.2026
3. Drejtoria e Arsimit menaxhon 24.8 % të totalit të buxhetit të bashkisë v.2026
4. Qendra Kulturore “Margarita Tutulani” menaxhon 4.3 % të totalit të buxhetit të bashkisë v.2026
5. Qendra “Lira” menaxhon 2.2 % të totalit të buxhetit të bashkisë v.2026
6. Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar menaxhon 4 % të totalit të buxhetit të bashkisë v.2026

Buxheti i rishikuar i Bashkisë Berat për vitin 2026, i ndarë sipas 6 njësive shpenzuese, arrin në vlerën 1,851,370,657 lekë. Për periudhën janar-prill 2026 janë realizuar shpenzime në shumën 478,268,568 lekë, ose 25.8% e planit vjetor.

Peshën më të madhe në strukturën e buxhetit e zë njësia Bashkia Berat qendër, me 48.79% të totalit të buxhetit të rishikuar, duke realizuar shpenzime në vlerën 218,489,040 lekë, ose 24.2% të planit vjetor. Më pas renditen

Drejtoria Arsimore, me 24.84% të strukturës dhe realizim në masën 28.1%, si dhe Agjencia e Shërbimeve Publike, me 15.86% të strukturës dhe realizim 27.4%.

Njësitë e tjera shpenzuese zënë një peshë më të vogël në totalin e buxhetit, konkretisht Qendra Kulturore “Margarita Tutulani” me 4.31%, Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar me 3.97% dhe Qendra “Lira” me 2.23%. Niveli i realizimit për këto njësi varion nga 23.4% deri në 27.8%, duke treguar ecuri përgjithësisht në përputhje me planifikimin për katërmujorin e parë të vitit.


Në tërësi, realizimi i shpenzimeve sipas njësive shpenzuese paraqitet në nivele të qëndrueshme dhe në përputhje me ritmin e zbatimit të buxhetit për periudhën raportuese, duke reflektuar vijimësinë e aktivitetit administrativ dhe ofrimit të shërbimeve publike për qytetarët sipas programeve të miratuara.

Realizimi i buxhetit në total për Bashkinë Berat sipas njësive shpenzuese për vitin 2026 paraqitet si më poshtë :

Vlerat paraqiten në: ALL

Nr	Kod Institucioni	Njësia Shpenzuese	2026	2026	Struktura	2026	Realizimi i planit vjetor
			Buxheti Fillestar	Buxheti i Rishikuar	%	Fakti Janar - Prill	ne %
1	2102001	Bashkia Berat qendra	738,042,401	904,067,124	48.81%	218,489,040	24.2%
2	2102004	Agjencia e Shërbimeve Publike	289,983,000	293,596,800	15.85%	80,460,455	27.4%
3	2102005	Drejtorja Arsimore Bashkia Berat	451,672,000	459,922,796	24.83%	129,418,540	28.1%
4	2102006	Qendra Kulturore "Margarita Tutulani"	75,547,000	79,844,300	4.31%	21,263,981	26.6%
5	2102020	Qendra "Lira"	40,267,000	41,308,534	2.23%	11,482,990	27.8%
6	2102022	Drejtorja e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve , Ujërave dhe Shërbimit Veterinar	67,308,191	73,449,657	3.97%	17,153,567	23.4%
		Total	1,662,819,592	1,852,189,211	100%	478,268,568	25.8%

Buxheti i Njësive Shpenzuese Janar - Prill 2026



Njësia shpenzuese Bashkia Berat (qendra) ka plan buxhetin vjetor 904,067,124 lekë, ose 48.81 % të buxhetit total të bashkisë. Në periudhën janar-prill plan buxheti është realizuar në shumën 218,489,040 lekë ose në masën 24.2%.

Vlerat paraqiten në: ALL

Bashkia Berat qendra						
kod	llog.	Emërtimi i Shpenzimeve	2026	2026	2026	Realizimi
institucioni	ekonomike		Buxheti Fillestar	Buxheti i Rishikuar	Fakt Janar-Prill	në %
2102001	600	Paga	275,023,000	274,796,600	78,806,694	28.68%
2102001	601	Sigurime Shoqërore	45,583,000	45,583,000	13,095,021	28.73%
2102001	602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	57,665,918	97,426,934	38,472,533	39.49%
2102001	603	Subvencione	29,000,000	29,000,000	13,350,000	46.03%
2102001	604	Transferta Korrente të Brendshme	125,000,000	127,000,000	37,806,141	29.77%
2102001	606	Transferta për Buxh. Fam. & Individë	10,800,000	13,468,719	2,011,025	14.93%
2102001	609	Rezervat	14,000,000	14,000,000	0	0.00%
2102001	230	Kapitale të Patrupëzuara	35,000,000	42,800,000	0	0.00%
2102001	231	Kapitale të Trupëzuara	145,651,483	259,991,870	34,947,626	13.44%
2102001	255	Te dala per hua-dhenie dhe nen-huadhenie te brendeshme	319,000	0	0	
2102001		total	738,042,401	904,067,124	218,489,040	24.17%

Njësia shpenzuese Agjencia e Shërbimeve Publike ka plan buxhetin vjetor 293,596,800 lekë, ose 15.85 % të buxhetit total të bashkisë. Në periudhën janar-prill plan buxheti është realizuar në shumën 80,460,450 lekë ose në masën 27.41 %.

Vlerat paraqiten në: ALL

Agjencia e Shërbimeve Publike						
kod	llog.	Emërtimi i Shpenzimeve	2026	2026	2026	Realizimi
institucioni	ekonomike		Buxheti Fillestar	Buxheti i Rishikuar	Fakt Janar-Prill	në %
2102004	600	Paga	126,377,000	126,377,000	38,911,700	30.79%
2102004	601	Sigurime Shoqërore	21,106,000	21,106,000	6,644,200	31.48%
